



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 72 Datë 28.05.2020

“Për miratim fondi per ndihme shtetërore financiare ”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139 datë 17. 12. 2015 “ Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 107 datë 22. 10. 2016 “ Për Prefektin e Qarkut “, Ligjit Nr. 45 datë 18. 07. 2019 “ Për Mbrojtjen Civile”, VKM Nr. 329 datë 16. 05. 2012 “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” **kreu III, pika 1, gërma ë,** dhe Vendimit nr. 76 prot datë 02. 08. 2017, pika III, Këshilli Bashkisë, në mbledhjen e tij, datë 28.05.2020 me 17 vota pro 2 vota kundër.

VENDOSI :

1. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor.
2. Të njohë vlerën totale të dëmit për objektin **shtëpi banimi 2 kat** në pronësi të z. **Riza Loka** njësia administrative Arras (fshati Sinë e Epërme) në shumën totale **784156** lekë sipas dokumentacionit të paraqitur nga ana e komisionit për këtë qëllim.
3. Nga kjo vlera e dëmit ndërtimor **583956** lekë dhe vlera e dëmit orendiak **200200** lekë.
4. Nga fondi emergjencave civile të bashkisë Dibër të trajtohet i dëmtuari në shumën prej **78415** lekë (20% e 50 % të vlerës totale të dëmit) për ti përdorur për riparimin e dëmit të shkaktuar.
5. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet drejtoria PPECK dhe sektori i financës.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Institucioni Prefektit Qarkut Dibër për bazueshmërinë ligjore.

Kryetar Këshilli

Sokol Sava

